



Fondi për të Drejtën Humanitare
Dokumentimi dhe Kujtesa

Humanitarian Law Center
Documentation and Memory

Fond za humanitarno pravo
dokumentovanje i pamćenje

Zbatimi i ligjit kundër diskriminimit dhe ligjit mbi përdorimin e gjuhëve në ndërmarrjet publike në Kosovë

Raporti i FDH-së Kosovë
Dhjetor 2007



Përmbajtja

Vërejtjet hyrëse.....	3
Rezyme	3
1. Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore	6
1.1. Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë	6
1.2. Ligji për përdorimin e gjuhëve	6
1.3. Ligji kundër diskriminimit	8
2. Post Telekom i Kosovës - PTK.....	9
2.1. Qendrat regjionale të PTK-së.....	11
3. Korporata energjetike e Kosovës - KEK.....	14
3.1. Qendrat regjionale të KEK-ut.....	15
4. Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës/ Priština	20
5. Ndërmarrja publike Hekurudhat e Kosovës	21
6. Kosovatransi	22
7. Ndërmarrja publike Termokos	23
8. Ujësjellësi dhe kanalizimi	24
8.1. Ndërmarrjet regjionale të ujësjellësve dhe kanalizimit.....	25
9. Shërbimi për pastrimin e qytetit	29
9.1. Ndërmarrjet publike regjionale.....	30
Rekomandimet.....	35

Vërejtjet hyrëse

Gjatë periudhës tetor-dhjetor të vitit 2007, Fondi për të Drejtën Humanitare-Kosovë (FDH-Kosovë) ka kryer një hulumtim për të parë sa zbatohet ligji kundër diskriminimit dhe ligji mbi përdorimin e gjuhëve, në ndërmarrjet publike në Kosovë. Në hulumtim janë përfshirë: *Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)*¹, *Post Telekom i Kosovës (PTK)*², *Hekurudhat e Kosovës*, *Kosovatransi*, *Termokosi*, *Aeroporti i Prishtinës/Priştinës*, ndërmarrjet publike regjionale të ujësjellësve dhe kanalizimit, si dhe ndërmarrjet regjionale që bëjnë pastrimin e qytetit, rregullimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe mirëmbajtjen e tregjeve dhe varrezave. Hulumtimi është kryer në të gjitha regjionet e Kosovës (Prishtinë/Priştina, Prizren/Prizren, Gjilan/Gnjilane, Pejë/ Peć dhe Mitrovicë/Mitrovica), në qendër dhe në qendrat regjionale të ndërmarrjeve publike.

Hulumtimi ka pasur për qëllim të mbledh të dhëna të cilat tregojnë nëse dhe në çfarë mase ndërmarrjet publike punësojnë pjesëtarët e komuniteteve pakicë, mundësinë që kanë pjesëtarët e pakicave për ta përdorur gjuhën e tyre amtare gjatë punëve së përditshme dhe raportin në mes të ndërmarrjeve publike dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të tyre (në cilën gjuhë bëhet faturimi, kontratat e punës si dhe informacione tjera).

Rezime

Ligji kundër diskriminimit³, përmes neneve 1, 2 (a, b) dhe 4 (a, b, c, d), u garanton pjesëtarëve të komuniteteve pakicë trajtim të barabartë, ndalon diskriminimin e drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt të cilitdo person për shkak të përkatësisë së tij kombëtare dhe garanton mundësi të barabarta për punësim në institucionet publike, në të gjitha nivelet, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare. Përmes neneve 11.2, 11.3, 30.1, 30.2 dhe 30.3 të ligjit mbi përdorimin e gjuhëve⁴, garantohej e drejta e pakicave kombëtare që në institucionet publike të komunikojnë në gjuhën e tyre amtare dhe të gjitha shërbimet, informatat dhe dokumentacionin tjetër ta marrin në cilën do prej gjuhëve zyrtare ose në gjuhën e cila „gëzon statusin e gjuhës që flitet në komunë“⁵.

FDH-Kosovë vlerëson se shkalla e zbatimit të ligjit kundër diskriminimit, për sa i përket punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, nuk është e kënaqshme. Pjesëtarët e komuniteteve pakicë në ndërmarrjet publike të Kosovës, nuk janë të përfaqësuar në mënyrë proporcionale me përqindjen e tyre në raport me numrin e përgjithshëm të banorëve të Kosovës⁶. Gjithashtu, FDH-Kosovë vlerëson se ligji mbi përdorimin e gjuhëve nuk zbatohet në tërësi, por shënon përparim veçanërisht në KEK, PTK, e sidomos në ndërmarrjet publike që merren me pastrimin e qyteteve. Ky përparim, në radhë të parë ka të bëjë me dhënien e kontratave të punës për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në gjuhën e tyre amtare. Vetëm romët nuk i marrin kontratat në gjuhën e tyre. Në disa raste ndodh që boshnjakët dhe turqit kërkojnë vetë që kontratat e punës të jenë në gjuhën shqipe, e jo në gjuhën e

¹ Kompania që ka pasuar Elektroekonominë e Serbisë (EPS)

² Kompania që ka pasuar PTT-në e Serbisë.

³ http://eëë.unmikonline.org/serbian/regulations/2004/rsc04_32alsl04_03.pdf

⁴ http://eëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2006_02-L37_sr.pdf

⁵ Gjithashtu.

⁶ FDH-Kosovë gjatë hulumtimit të saj është bazuar në të dhënat statistikore të OSBE-së mbi popullsinë e Kosovës sipas parimit etnik, të shprehur në përqindje.

tyre amtare. Boshnjakëve dhe myslimanëve⁷ kontratat e punës kryesisht u jepen në gjuhë serbe, kurse turqve në gjuhën shqipe.

FDH-Kosovë vlerëson se, në krahasim me të gjitha ndërmarrjeve publike në Kosovë, ligji mbi përdorimin e gjuhëve respektohet më së shumti në *Aeroportin e Prishtinës/Priština*. Udhëheqësit e aeroportit kujdesen që të zbatohen në tërësi të gjitha dispozitat e ligjit mbi përdorimin e gjuhëve dhe ligjit kundër diskriminimit.

Me qëllim të përmirësimit të punësimit dhe integritit të pjesëtarëve të pakicave, në gusht të vitit 2007, PTK-ja krijoi departamentin për integrimin e komuniteteve, drejtori i së cilës është serb.

Për sa u përket ndërmarrjeve publike regjionale të ujësjellësve dhe kanalizimit, ngrohjes dhe kompanive për transport publik, ligji mbi përdorimin e gjuhëve pothuajse fare nuk zbatohet. Në shumicën e rasteve, këto ndërmarrje publike nuk kanë bërë pothuajse asgjë për të zbatuar dispozitat e këtij ligji. FDH-Kosovë konstaton përparim në ndërmarrjet e *Ujësjellësit të Prishtinës/Priština* dhe *Hidromorava e Gjilanit/Gnjilane*, sepse në këto kompani kontratat e punës dhe vendimet për pushim për punëtorët serbë jepen në gjuhën serbe.

Komunikimi në mes të kolegëve në të gjitha ndërmarrjet publike, zhvillohet plotësisht në mënyrë të lirë në të gjitha gjuhët. Të gjithë zyrtarët e ndërmarrjeve publike u përgjigjen palëve në gjuhën në të cilën ata u drejtohen.

Karakteristikë kryesore e ndërmarrjeve të cilat aktivitetin e vet e kryejnë në gjithë territorin e Kosovës (KEK-u, PTK-ja, *Kosovatransi*, *Hekurudhat e Kosovës*), është struktura e centralizuar, kurse për PTK-në është karakteristikë edhe mungesa e transparencës. Administrata e ndërmarrjeve publike e KEK-ut, PTK-së dhe *Kosovatransit* gjendet në Prishtinë/Priština, kurse administrata e *Hekurudhave të Kosovës* në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. I gjithë dokumentacioni (si p.sh. kontrata e punës) përgatitet në Prishtinë/Priština, respektivisht në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Procedura e punësimit dhe të gjitha vendimet për punësim merren në qendrat e këtyre ndërmarrjeve, pa marrë parasysh nëse punëtorët e ardhshëm do të punojnë në qendër ose në qendrat regjionale të këtyre ndërmarrjeve publike.

Prej numrit të përgjithshëm të punësuarve në ndërmarrjet publike, përqindja e pakicave të punësuarra në to është si vijon: në PTK janë të punësuar 4,71% pjesëtarë të pakicave, në KEK 2,27%, në *Aeroportin e Prishtinës/Priština* 2,5%, në *Hekurudhat e Kosovës* 12%, në *Kosovatrans* 5,8% dhe në *Termokos* Prishtinë/Priština dhe Ngrohja Qendrore Gjakovë/Đakovica 3,5 %.

Përqindja më e lartë e të punësuarve nga radhët e komuniteteve pakicë në ndërmarrjet publike që merren me furnizim me ujë dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, është shënuar në ujësjellësin regjional *Hidroregjioni jugor* në Prizren/Prizren (36% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve), kurse më së paku ka në *Ujësjellësin e Mitrovicës/Mitrovica*, ku janë të punësuar vetëm 5,1% të pjesëtarëve të pakicave.

Sa u përket ndërmarrjeve publike që merren me pastrim, përqindjen më të lartë të punësimit të pakicave e ka kompania *Çabrati* në Gjakovë/Đakovica (56% prej numrit të përgjithshëm të të

⁷ Pjesëtarët e grupit *myslimanë* janë kryesisht boshnjakët dhe goranët etnik

punësuarve), kurse përqindja më e ulët është në ndërmarrjen publike *Pastrimi* në Prishtinë/Priština, vetëm 2%.

1. Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

1.1. Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë

Të drejtat e njeriut

3.1 Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

3.2 Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në:

- (a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;
- (b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj;
- (c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e Saj;

Të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre:

4.4 Komunitetet dhe anëtarët e tyre kanë të drejtë:

- (a) Të përdorin lirisht gjuhën dhe alfabetin e tyre, duke përfshirë përdorimin e saj para gjykatave, organizmave dhe organeve të tjera publike në Kosovës;
- (c) Të gëzojnë të drejtën për informacion në gjuhën e tyre;
- (d) Të gëzojnë të drejta të barabarta në lidhje me punësimin në organet publike të të gjitha niveleve dhe në shërbimet publike të të gjitha niveleve;
- (f) Të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit në përputhje me ligjin;
- (m) Të marrin dhe të ofrojnë shërbime shëndetësore publike dhe shërbime shoqërore, mbi baza jo diskriminuese, në përputhje me standardet e aplikueshme;

1.2. Ligji për përdorimin e gjuhëve

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1.1. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë:

- i. Përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike;
- ii. Status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të drejta të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës;
- iii. Të drejtën e të gjitha komuniteteve të Kosovës për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor;
- iv. Karakterin shumë gjuhësor të shoqërisë kosovare, që paraqet vlerat e saj unike shpirtërore, intelektuale, historike dhe kulturore.

Neni 2

2.1. Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.

2.2. Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës.

2.3. Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën s, paku 5 përqind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do t, ketë statusin e gjuhës zyrtare në at, komunë dhe do përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësisht kësaj që u tha më lartë, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha Turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare.

Neni 3

3.1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pranuar, kërkuar dhe për të dhënë informata dhe ide në gjuhën e zgjedhur, pa ndërhyrje. Pranimi i lirë i transmetimit tejkufitar, qoftë i drejtpërdrejtë apo nëpërmjet të ritransmetimit apo riemetimit nuk ndalohe në baza të gjuhës. Ushtrimi i kësaj lirie mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tilla, që janë në pajtueshmëri me traktatet ndërkombëtare obliguese të të drejtave të njeriut.

3.2. Çdo person ka të drejtën për barazi para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Ndalohet çdo diskriminim në baza gjuhësore.

Përdorimi i gjuhëve në ndërmarrjet publike

Neni 11

11.1. Në ndërmarrjet që janë në pronësi publike dhe në ndërmarrjet në pronësi shoqërore aplikohet barazia e gjuhëve zyrtare.

11.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet nga ndërmarrjet në pronësi publike dhe nga ndërmarrjet në pronësi shoqërore në cilëndo nga gjuhët zyrtare.

11.3. Çdo ndërmarrje e tillë ka për detyrë të sigurojë që çdo person të mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet në cilëndo gjuhë zyrtare.

Emrat personal

Neni 27

27.1. Emri dhe mbiemri i personit regjistrohet në regjistrat publikë, në dokumentet për identifikim personal dhe në dokumente të tjera zyrtare në sistemin me shkrim në gjuhët zyrtare të zgjedhur nga ai person.

27.2. Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, do të kenë të drejtën të regjistrojnë formën origjinale të emrit dhe mbiemrit të tyre në shkrimin dhe në pajtueshmëri me traditat dhe sistemin linguistik të gjuhës së tyre, si në regjistrat publikë, në dokumente për identifikim personal dhe në dokumente të tjera zyrtare, si dhe kjo formë do të përdoret nga zyrtarët publikë.

Neni 30

30.1. Në ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike aplikohet barazia e gjuhëve zyrtare në kryerjen e këtyre shërbimeve.

30.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet nga ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike në cilëndo gjuhë zyrtare. Çdo ndërmarrje e tillë ka për detyrë të sigurojë që çdo person të mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet në cilëndo gjuhë zyrtare.

30.3. Në komunat e banuara nga komunitetet, gjuha e të cilave gëzon statusin e gjuhës që flitet në komunë, vlejnë dispozitat e neneve 30.1 dhe 30.2.

1.3.Ligji kundër diskriminimit

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligjit.

Neni 2

Parimet

Rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin mbështetet në këto parime:

- a). Parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, races, pronës, lindjes ose statuseve tjera;
- b). Parimin e përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me punësim në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet.
- c) Parimin e mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike të qytetarëve të Kosovës.

Neni 4

Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat çënojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, në fushat si vijon :

- a). kushteve për qasje në punësim, vetë punësim dhe të punësimit në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit dhe kriteriet e përzgjedhjes, pa marë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale dhe avansimimet;
- b). qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avansuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike;
- c). kushtet e punësimit dhe kushtet e punës, përfshirë shkarkimin nga puna dhe pagesën;

d). anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve ose të çdo organizate tjetër anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesione të caktuara, përfshirë edhe fitimet që mundësohen nga organizatat e tilla;

Neni 5

Kërkesat reale dhe pëcaktuese me rastin e punësimit

Pamvarsisht nga nenet 2 a, 3a dhe 3 b, nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim i cili bazohet në dallimet e dhëna në bazat nën 2 a, mirëpo i cili si i tillë paraqet karakteristikën reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit, qoftë për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, me kusht që qëllimi të jetë legjitim e kërkesat proporcionale me qëllimin.

2. Post Ttelekomi i Kosovës - PTK

Në ndërmarrjen publike të PTK-së janë të punësuar 2484 punëtor⁸. Prej këtij numri, 117 punëtorë janë pjesëtar të komuniteteve pakicë⁹. Pjesën më të madhe të punëtorëve joshqiptarë e përbëjnë serbët (41).¹⁰ Ata punojnë në enklavat serbe në komunat Prishtinë/Priština (22), Prizren/Prizren (4), Mitrovicë/Mitrovica (11), Pejë/Peć (2) i Gjilan/Gnjilane (2). 32 punëtorë janë pjesëtar të pakicës turke¹¹ të cilët punojnë në komunat Prishtinë/Priština (13), Prizren/Prizren (18), dhe Gjilan/Gnjilane (1). Nga komuniteti «Mysliman»¹² janë të punësuar gjithsej 30 punëtor.¹³ Ata punojnë në komunat Prishtinë/Priština (2), Prizren/Prizren (16), Mitrovicë/Mitrovica (3) dhe Pejë/Peć (9). Gjithsej janë të punësuar 14 ashkalinjë, romë, egjiptas dhe çerkez¹⁴, të cilët punojnë në komunat Prizren/Prizren (11), Mitrovicë/Mitrovica (2), dhe Gjilan/Gnjilane (1).

⁸ K.G. drejtor i departamentit të resurseve humane në PTK; Intervistë e FDH, 18 dhe 23 tetor 2007.

⁹ 4.71% prej numrit të përgjithshëm të punësuarve.


¹⁰ 1.65% prej numrit të përgjithshëm të punësuarve.

¹¹ 1.28% prej numrit të përgjithshëm të punësuarve.


¹² Pjesëtarë të këtij komuniteti janë kryesisht boshnjakët dhe goranët etnik.

¹³ 0,8% prej numrit të përgjithshëm të punësuarve.

¹⁴ 0.56% prej numrit të përgjithshëm të punësuarve.



Struktura etnike e popullsisë së Kosovës¹⁵



Struktura etnike e të punësuarve në PTK

Prej serbëve të punësuar, tre janë me shkollim të lartë, 37 kanë përgatitje të mesme profesionale, kurse njëri e ka të kryer shkollën fillore. Një pjesëtar i komunitetit turk ka të kryer fakultetin, katër shkollën e lartë, 26 janë me përgatitje të mesme profesionale, kurse njëri e ka të kryer shkollën fillore. Prej grupit të *myslimanëve* një i punësuar e ka të kryer fakultetin, shtatë shkollën e lartë, 17 kanë përgatitje të mesme profesionale dhe pesë janë vetëm me shkollë fillore. Gjashtë nga grupi i ashkalinjëve, romëve, egjiptasve dhe çerkezëve kanë përgatitje të mesme profesionale, kurse tetë prej tyre kanë të kryer shkollën e mesme.¹⁶

Emërtimet në hyrje të qendrave të PTK-së janë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Kontratat e punës për të punësuarit nga radhët e pakicës serbe përgatiten në gjuhën serbe. Kontratat e punës për boshnjakët dhe turqit përgatiten në gjuhën shqipe. Nuk ka qenë problem përgatitja e kontratave në gjuhët e këtyre pakicave, por vet boshnjakët dhe turqit e punësuar kanë insistuar që ato të përgatiten në gjuhën shqipe. Në PTK ekziston shërbimi për përkthime në të cilën punojnë tre përkthyes. Përkthyesit bëjnë përkthimin e dokumentacionit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Në rastet kur paraqitet nevoja për të përkthyer ndonjë dokumentacion voluminoz, PTK-ja zakonisht angazhon agjenci të ndryshme për përkthim. Në mbledhjet ku marrin pjesë serbët sigurohet përkthim konsektiv. Dokumentacioni që u jepet palëve, siç janë faturat, kontratat për shlyerjen e borxhit, kërkesat për numrin e ri të telefonit etj. janë në gjuhën shqipe dhe serbe. Rregulloret e punës gjithashtu janë përgatitur në këto dy gjuhë. Megjithatë, dokumentacioni i brendshëm, informacionet në tabelat e shpalljeve në objektet e PTK-së, emrat e të punësuarve dhe emërtimet e shërbimeve janë në gjuhën shqipe. Komunikimi me pjesëtarët e pakicave kombëtare bëhet në gjuhën në të cilën palët u drejtohen zyrtarëve të PTK-së. Kolegët komunikojnë mes vete lirisht në të gjitha gjuhët.

Logoja e PTK-së sikurse edhe ueb-faqja është në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Ueb-faqja azhurnohet rregullisht në të gjitha gjuhët.

¹⁵ Burim i të gjithë diagrameve të prezantuara në këtë hulumtim është Misioni i OSBE-së në Kosovës, www.osce.org/municipalprofiles/2007. Diagramet në të majtë paraqesin strukturën etnike të popullsisë ose të regjioneve të Kosovës. Diagramet në të djathtë tregojnë strukturën etnike të punësuarve në ndërmarrjet publike në nivel të gjithë kompanisë në nivel të qendrave regionale të kompanisë së caktuar.

¹⁶ K.G. drejtor i departamentit të resurseve humane në PTK; Intervistë e FDH, 18. i 23. tetor 2007.

PTK-ja shpall konkurse për vende të punës në shtypin e përditshëm si dhe në ueb-faqen e saj në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Nuk ka të dhëna për strukturën etnike e të punësuarve, që para lufte kanë punuar në PTT-në e Serbisë. Me rregulloren e UNMIK-ut 1999/12¹⁷, neni 2, paragrafi 2.3, është marrë vendim që të kthehen në punë ish-punëtorët PTT-së së Serbisë të cilët kanë qenë të punësuar në Kosovë, që PTK-ja të udhëheq një politikë jo diskriminuese në punësim dhe që zyrtarët e punësuar të reflektojnë karakterin multi-etnik të Kosovës. Një numër i serbëve të punësuar në PTT të Serbisë, më konkretisht 16 prej tyre, janë kthyer në punë dhe kanë filluar të punojnë në PTK.

Në mënyrë që të iniciojë punësimin e pjesëtarëve të pakicave në PTK dhe me qëllim të integritimit të tyre sa më të shpejtë, në gusht të vitit 2007 PTK-ja e hapi Departamentin për integrimin e komuniteteve, drejtori i së cilit është një serb. Gjithashtu, ky departament ka për qëllim edhe re-integrimin e ndërmarrjeve të PTK-së të cilat momentalisht shfrytëzohen nga PTT-ja e Serbisë.

PTK-ja nuk shpall konkurse vetëm për punësimin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, por, kur shpallim konkurs, për shembull në Mitrovicë, është normale që në të konkurrojnë edhe serbët. Bazë për shpallje të konkursit është nevoja e PTK-së për plotësimin e atij vendi të punës, kurse ndarja e vendeve të punës bëhet në bazë të strukturës demografike të popullsisë, sipas regjistrimit të vitit 1981, respektivisht në bazë të ndarjes së vendeve për deputet në parlament ... Strategjia jonë në punë ka të bëjë para së gjithash me punësimin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare. Para hapjes së këtij departamenti, në PTK kanë punuar rreth 15 serbë derisa sot punojnë 41, këtë unë e shoh si sukses.

S. P. Drejtor i Departamentit për integrimin e pakicave në PTK
Intervistë e FDH, 24 tetor 2007.

Në përputhje me rregulloren e UNMIK-ut të vitit 1999/12, pas lufte, në punë janë pranuar punëtorët të cilët kanë punuar para qershorit të viti 1999. Përmes mediumeve dhe shërbimeve të RTK-së, i kemi njoftuar të interesuarit se mund të kthehen në punë deri në një afat të caktuar. Janë kthyer 16 punëtorë pjesëtarë të pakicës serbe ... Kohëve të fundit kemi vendosur rrjetin e shpërndarjes së postës edhe në pjesën veriore të Kosovës, ku funksionon sistemi paralel i PTT-së së Serbisë. Në fillim punëtorët tanë janë kërcënuar, por incidente nuk ka pasur.



K.G. drejtor i resurseve njerëzore në PTK
Intervistë e FDH, 18 dhe 23 tetor 2007.

2.1. Qendrat regjionale të PTK-së



Qendra regjionale e PTK-së që gjendet në Gjilan/Gnjilane, mbulon komunat Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica dhe Viti/Vitina. Prej 167 punëtorëve, që paraqet numrin e përgjithshëm të të punësuarve, gjashtë prej tyre janë pjesëtarë të pakicave kombëtare: 4 serbë dhe nga një turk dhe ashkali. Dy serbë punojnë në fshatrat e komunës së Vitisë/Vitina, dhe nga një në enklava, në komunat e Kamenicës/Kamenica dhe Gjilan/Gnjilane. Të gjithë kanë përgatitje të mesme profesionale. Tre serbë kanë filluar të punojnë pas lufte, kurse njëri, që punon në komunën e Vitisë, para qershorit të vitit 1999 ka punuar në PTT-në e Serbisë. Në Gjilan/Gnjilane janë të punësuar pjesëtarët e komunitetit turk dhe ashkali: turku është punëtor i kualifikuar dhe është punësuar pas

¹⁷ www.unmikonline.org/sluzbeni_list/odredbe/1999



qershorit të vitit 1999, kurse ashkaliu ka përgatitje të mesme profesionale; edhe ky para lufte ka punuar në PTT-në e Serbisë.





Selia e PTK-së për komnat Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vuçitrn është në Mitrovicë/Mitrovica. Në këto qendra janë të punësuar gjithsej 213 punëtorë, mes të cilëve 12 janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë (3,22%): tetë serbë dhe nga dy boshnjakë dhe ashkalinjë. Të gjithë serbët janë të punësuar në Zubin Potok/Zubin Potok dhe atë pas qershorit të vitit 1999. Boshnjakët dhe ashkalinjtë para lufte kanë qenë të punësuar në PTT-në e Serbisë në Mitrovicë/Mitrovica. Ata kanë përgatitje të mesme profesionale.



Qendra regjionale për komunën Ferizaj/Uroševac, Kaçanik/Kaçanik, Shtime/Štimlje, Shtërpçë/Štrpce dhe pilot komunën Hani i Elezit/Đeneral Janković është në Ferizaj/Uroševac. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 186 dhe të gjithë janë shqiptarë.




Selia e PTK-së për komunën e Pejës/Peć, Klinës/Klina, Istogut/Istog dhe Deçanit/Dečane është në Pejë/Peći. Në këto komuna janë të punësuar gjithsej 180 punëtorë, 12 prej të cilëve janë pjesëtarë të pakicave kombëtare: të punësuarit janë tre serbë dhe nëntë boshnjakë. Dy serbë janë të punësuar në Gorazhdëc/Goraždevac, kurse njëri në Pejë/Peći. Të gjithë kanë përgatitje të mesme profesionale. Pesë boshnjakë janë të punësuar në Pejë/Peći, kurse katër të tjerë në Istog/Istok. Tetë boshnjakë kanë përgatitje të mesme profesionale, kurse njëri ka të përfunduar fakultetin.



3. Korporata energjetike e Kosovës - KEK

Në KEK janë të punësuar 7.452 punëtorë. Prej tyre, 100 punëtorë janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë (2,27%). Më të shumtë në numër janë turqit (28 punëtorë ose 0,36%) dhe punëtorët të cilët deklarohen si *myslimanë* (28 punëtorë ose 0,36%). Turqit kryesisht janë punësuar në regjionin e Prizrenit/Prizren, kurse *myslimanët* pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës. Në KEK janë të punësuar 25 pjesëtarë të komunitetit serb (0,32%) dhe atë kryesisht në enklavat serbe si: Shtërpcë/Štrpce, Gorazhdëc/Goraždevac, Zvečan/Zvečan dhe në fshatrat serbe në komunën e Gjilanit/Gnjilane, Kamenicës/Kamenica dhe Vitisë/Vitina. Gjithsej 16 punëtorë të grupit të *tjerët* (çerkezët, jugosllavët, kroatët ose 0,24%) punojnë në Dragash/Dragaš. Tre pjesëtarë të komunitetit rom (0,04%) janë të punësuar në qendrat e KEK-ut në Prizren/Prizren dhe në Pejë/Peć.



Për sa i përket përgatitjes shkollore, një pjesëtar i komunitetit turk ka diplomë universiteti, nëntë kanë diploma të shkollës së lartë, pesë kanë përgatitje të mesme profesionale, përderisa 13 punëtorë kanë diplomën e shkollës së mesme. Tre *myslimanë* kanë të kryer fakultetin, 14 janë me shkollë të lartë, 10 me përgatitje të mesme profesionale, kurse një nuk është i kualifikuar. Prej 25 serbëve të punësuar njëri është me fakultet, dy kanë të kryer shkollën e lartë, 20 punëtorë kanë përgatitje të mesme profesionale, kurse dy prej tyre kanë të kryer shkollën e mesme. Sa u përket 18 punëtorëve të KEK-ut nga grupi të *tjerët*, dy kanë të kryer fakultetin, gjashtë janë me përgatitje të mesme profesionale, kurse tetë janë me shkollë fillore. Nga tre romët e punësuar, njëri ka përgatitje të mesme profesionale, kurse dy të tjerët shkollën fillore.¹⁸

Emërtimet në hyrje të gjitha qendrave të KEK-ut janë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Kontratat e punës për të gjithë të punësuarit përgatiten në qendrën e KEK-ut në Prishtinë/Priština. Serbëve kontrata e punës u jepën në gjuhën serbe, sikurse edhe gjithë dokumentacioni tjetër siç janë vendimet për pushim etj. Disa serbëve që janë punësuar para aprovimit të ligjit mbi përdorimin e

¹⁸ B. H., drejtor i Divizionit të resurseve humane në KEK; Intervistë e FDH, 23. tetor 2007.

gjuhëve¹⁹ kontratat e punës i kanë në gjuhën shqipe. Sipas informatave që FDH-Kosovë i ka marrë në KEK, këto kontrata do të përkthehen në gjuhën serbe, në përputhje me ligjin. Pjesëtarëve të gjithë komuniteteve tjera kontratat e punës u jepen vetëm në gjuhën shqipe. Sipas njohurive që i ka FDH- Kosovë, disa boshnjakë dhe turq vetë kanë insistuar që t'i marrin kontratat në gjuhën shqipe.

I gjithë dokumentacioni i brendshëm në KEK-, informatat në tabelat e shpalljeve, emrat e të punësuarve dhe emërtimet e shërbimeve janë në gjuhën shqipe.

Në KEK ekziston shërbimi për përkthim, i cila bën përkthimin e dokumenteve në gjuhën serbe dhe angleze, si dhe prej gjuhëve tjera në gjuhën shqipe. Në mbledhjet ku marrin pjesë punëtorët serbë, sigurohet përkthim konsektiv në gjuhën serbe. Faturat mbi shpenzimin e energjisë elektrike lëshohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Komunikimi me palë bëhet në gjuhën në të cilën palët u drejtohen zyrtarëve të KEK-ut.

KEK-u shpall konkurse për vende të punës në shtypin ditor, në gjuhën shqipe dhe serbe. Ueb-faqja e KEK-ut është në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze dhe azhurnohet në të gjitha gjuhët. Komunikimi mes kolegëve zhvillohet pa asnjë problem në të gjitha gjuhët. Palët marrin përgjigje prej zyrtarëve të KEK-ut në gjuhën në të cilën u janë drejtuar.

Në KEK nuk ka informata sa ka qenë numri i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe çfarë ka qenë përfaqësimi numerik dhe procentual i të punësuarve në ndërmarrjen publike Elektroekonomia e Serbisë (EES) para lufte, trashëguese e së cilës është KEK-u. KEK-u ka njoftuar përmes medieve të gjithë ish punëtorët e vet që të kthehen në punë deri më 30. qershor 2000. Punëtorët të cilët deri në atë ditë nuk janë kthyer në punë janë përjashtuar.



Kur bëhet fjalë për serbët dhe komunitetet tjera pakicë, e dimë se pas lufte ata nuk janë lajmëruar në punë, sipas të gjitha gjasave për shkak të situatës së përgjithshme ... Ka edhe arsye politike për refuzimin e tyre që të punojnë në KEK: 7.000 deri 8.000 ish punëtorë akoma marrin rrogë nga EES-ja, në mesin e të cilëve edhe punëtorët që sot punojnë në KEK në regjionin e Gjilanit dhe Mitrovicës ...Si shembull i refuzimit të punës është KOSOVAMONTI i cili është në kuadër të KEK-ut dhe ndodhet në rrethinën e Obiliqit. Pas lufte u arrit marrëveshje që 150 serbë të kthehen në punë. Fabrikën e ruante KFOR-i, kështu që siguria ishte në nivel, por edhe vet fabrika ndodhet pranë vendbanimeve serbe. Në fillim ata kanë pranuar, por më pas, kur KFOR-i i ftoi që t'i përgatisin dokumentet personale, ata kanë refuzuar të kthehen në punë sepse kanë marrë instruksione të tilla nga dikush.

B. H., drejtor i Divizionit të resurseve humane në KEK
FDH intervistë 23. tetor 2007.

3.1. Qendrat regjionale të KEK-ut

Në regjionin e Prishtinës/Priştine në KEK janë të punësuar 6.000 punëtorë, 24 prej të cilëve janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë (0.4 %): gjashtë serbë, 10 punëtorë prej grupit të *myslimanëve*, tre turq dhe pesë prej grupit të *tjerët* (çerkezët, goranët dhe jugosllavët). Të gjithë pjesëtarët e pakicave janë të punësuar në komunën e Prishtinës/Priştina. Përndryshe, qendra regjionale e KEK-ut në Prishtinë/Priştina është përgjegjëse për komunat /Fushë Kosovë /Kosovo Polje, Podujevë/Podujevo, Obliq/Obiliq, Glllogoc/Glogovac, Shtime/Shtimlje dhe Lipjan/Lipljan.

¹⁹ korrik 2006.





Qendra regjionale e KEK-ut me seli në Prizren/Prizren përfshin komunat e Prizrenit/Prizren, Dragashit/Dragaš, Suharekës/Suva Reka, Malishevës/Mališevo dhe Rahovecit/Orahovac. Gjithsej ka 322 punëtorë, prej të cilëve 38 janë pjesëtarë të pakicave kombëtare (11,4%): 20 turq, 13 myslimanë, dy romë, dy goranë dhe një boshnjak.

Turqit dhe romët punojnë në territorin e komunës së Prizrenit/Prizren, myslimanët në atë të Dragashit/Dragaš dhe një numër më i vogël në komunën e Prizrenit/Prizren. Goranët dhe një boshnjak punojnë në komunën e Dragashit/Dragaš. Shumica e të punësuarve nga radhët e pakicave kanë përgatitje të mesme profesionale, kurse të tjerët shkollën fillore.



Serbë të punësuar në KEK nuk ka sepse ata që kanë punuar para luftime në këtë ndërmarrje nuk janë lajmëruar në punë pas qershorit të vitit 1999. Sipas ligjit, nëse një punëtor mungon për pesë ditë pa arsye, plotëson „kushtin“ që të largohet nga puna, megjithatë ne i kemi pritur të lajmërohen në vendet e punës deri në shtator të vitit 1999. Asnjë prej tyre nuk është lajmëruar, ose nuk ka shprehur interesim që të kthehet në punë edhe pse ne i kemi lajmëruar përmes medieve dhe e kemi publikuar në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjes tonë.

B. P., zyrtar në sektorin për resurse humane në KEK – regjioni i Prizrenit/Prizren
FDH Intervistë, 6 nëntor 2007





Selia e KEK-ut për komunën e Mitrovicës/Mitrovica, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn është në Mitrovicë/Mitrovica. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 201; 10 prej tyre janë nga radhët e komuniteteve pakicë (4.97%) dhe atë: katër nga komuniteti serb, dy nga komuniteti turk dhe katër punëtorë janë prej grupit të *myslimanëve*.

Serbët janë të punësuar në Zveçan/Zvečan: njëri prej tyre ka punuar aty edhe para qershorit të vitit 1999, derisa tre të tjerët janë punësuar pas përfundimit të konfliktit të armatosur. Pjesëtarët e komunitetit turk dhe myslimanë janë punësuar në territorin e komunës së Mitrovicës/Mitrovica: një turk ka qenë i punësuar para lufte kurse tjetri është punësuar pas qershorit të vitit 1999. Dy boshnjakë kanë punuar në këtë ndërmarrje edhe para lufte, derisa dy të tjerë janë punësuar pas qershorit të 1999-ës. Të gjithë të punësuarit nga radhët e komuniteteve pakicë kanë përgatitje të mesme profesionale.



Qendra regjionale e KUK-ut që gjendet në Gjilan/Gjilane, mbulon komunat Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica dhe Viti/Vitina. Prej 225 sa është numri i përgjithshëm i punëtorëve, 10 janë pjesëtarë të pakicave (4,4%), tetë serbë dhe dy turq.

Katër serbë punojnë në komunën e Kamenicës/Kamenica, tre në atë të Gjilanit/Gnjilane dhe një në komunën e Vitisë/Vitina. Të gjithë ata kanë përgatitje të mesme profesionale dhe janë punësuar pas luftime. Turqit punojnë në komunën e Gjilanit/Gnjilane dhe aty kanë qenë të punësuar para qershorit të vitit 1999: një nga ata ka shkollën e lartë kurse tjetri atë të mesme.²⁰





Qendra regjionale e KEK-ut për komunat Ferizaj/Uroševac, Kaçanik/Kaçanik, Lipjan/Lipljan, Shtime/Štimlje, Shtërpçë/Štrpce dhe pilot komunën e Hanit të Elezit/Đeneral Janković gjendet në Ferizaj/Uroševac. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 260, prej tyre pesë janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë (1,92%), katër serbë dhe një ashkali.



Të gjithë serbët punojnë në komunën e Shtërpçës/Štrpce: njëri prej tyre ishte i punësuar në EES-në para luftime, derisa tre të tjerë kanë filluar me punë pas qershorit të vitit 1999. Një nga serbët e punësuar ka të kryer fakultetin, kurse të tjerët kanë përgatitje të mesme profesionale. Ashkaliu punon në komunën e Ferizajt/Uroševac, ka të kryer shkollën fillore dhe ka qenë i punësuar në EES-në edhe para luftës.²¹

²⁰ N. Sh, zyrtar në sektorin për financa në KEK, Gjilan/Gjilane; Intervistë e FDH, 1 nëntor 2007.

²¹ R. Rr, zyrtar në sektorin për financa në KEK– Ferizaj/Uroševac; Intervistë FDH 5 nëntor 2007.



Selia e KEK-ut për komunat Pejë/Peç, Klinë/Klina, Istog/Istok dhe Deçan/Deçane, gjendet në Pejë/Peç. Në këto komuna janë të punësuar gjithsej 280 punëtorë, prej të cilëve 10 janë nga radhët e komuniteteve pakicë (3,57%): tre serbë, gjashtë boshnjakë dhe një nga komuniteti RAE. Të gjithë serbët punojnë në Gorazhdec/Goraždevac, kurse boshnjakët dhe punëtorët nga radhët e komunitetit RAE, punojnë në Pejë/Peç. Një serb e ka fakultetin, derisa dy të tjerë kanë përgatitje të mesme profesionale. Katër boshnjakë kanë diplomën e shkollës së lartë kurse dy të shkollës së mesme. Pjesëtari i komunitetit RAE ka përgatitje të mesme profesionale.





Konsumatorët tanë që kanë probleme të ndryshme ose ndonjë kërkesë që ka të bëjë me energjinë elektrike, vijnë këtu dhe komunikojnë me ne në gjuhën e tyre. Faturat janë të përgatitura në gjuhën serbe, shqipe dhe angleze. Rregulloret e brendshme për punëtorët e KEK-ut përgatiten në Prishtinë dhe unë nuk kam informatë nëse këto rregullore janë përkthyer në gjuhën serbe.

H.M., koordinator i shërbimit për përkujdesje ndaj konsumatorëve në KEK
Intervistë e FDH 31 tetor 2007.

Kontratat përgatiten dhe nënshkruhen në Prishtinë. Zyra e resurseve humane në Pejë, përpos listës së ardhjes dhe shkuarjes së punëtorëve nuk ka asnjë dokumentacion tjetër që ka të bëjë me punëtorët e KEK-ut.

R. T, administrator i resurseve humane në KEK – për regjionin e Pejës/Peë
Intervistë FDH, 31 tetor 2007.



Qendra regjionale e KEKut për komunat Gjakovë/Đakovica, Rahovec/Orahovac dhe Malishevë/Mališevo, gjendet në Gjakovë/Đakovica. Gjithsej ka 162 të punësuar. Të gjithë të punësuarit janë shqiptarë.



4. Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës/Priština

Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës/Priština gjendet në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje. Në aeroport janë të punësuar gjithsej 577 punëtorë, prej të cilëve 13 punëtorë ose 2,5% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve janë pjesëtarë të pakicave kombëtare: pesë serbë, dy boshnjakë, dy pjesëtarë të bashkësive RAE dhe katër turq. Në aeroport është i punësuar gjithashtu edhe një shtetas i Sirisë.

Serbët dhe pjesëtarët e komunitetit RAE janë staf teknik dhe të gjithë kanë përgatitje të mesme profesionale. Boshnjakët dhe turqit kanë përgatitje të lartë profesionale dhe punojnë si menaxherë.



Kontratat e punës për serbët përgatiten në gjuhën serbe. Për punëtorët nga radhët e komuniteteve tjera pakicë, si për shembull për turqit dhe boshnjakët, kontratat përgatiten në gjuhën shqipe. Shpalljet për punësim publikohen në shtypin ditor dhe në ueb-faqen e aeroportit, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Procesi i punësimit (testi i shkruar dhe intervistimi) bëhet në gjuhën angleze. Mbledhjet e të punësuarve zhvillohen vetëm në gjuhën angleze. Dokumentacioni i brendshëm, siç janë rregulloret dhe dokumentet tjera, përgatitet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Të gjitha informatat e ofruara në aeroport, qoftë përmes mikrofonit apo ato në tabelat e shpalljeve, janë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Në aeroport janë të punësuar edhe dy përkthyes që përkthejnë nga gjuha serbe në atë shqipe dhe anasjelltas.

Ueb-faqja dhe logoja e aeroportit janë në gjuhën angleze.

Meqenëse aeroporti i Prishtinës është aeroport ndërkombëtar, gjuhë zyrtarë është anglishtja. Madje, edhe në rastet kur të gjithë të pranishmit janë shqiptarë, ne mbledhjen e mbajmë në gjuhën angleze sepse ashtu janë rregullat.

B.Z. drejtor i resurseve humane në Aeroportin e Prishtinës/Priština
Intervistë e FDH, 15 nëntor 2007.

Aeroporti punon në përmbushjen e të gjitha ligjeve që janë në fuqi. Në këtë aspekt, ne punojmë edhe në drejtim të zbatimit të ligjit mbi përdorimin e gjuhëve dhe ligjit kundër diskriminimit.

F.Xh., drejtor i administratës së Aeroportit të Prishtinës/Priština
Intervistë e FDH, 15 nëntor 2007.



5. Ndërmarrja publike Hekurudhat e Kosovës

Në ndërmarrjen *Hekurudhat e Kosovës* gjithsej janë të punësuar 346 punëtorë, prej të cilëve 43 pjesëtarë të komuniteteve pakicë (12%): 41 serb, një ashkali dhe një boshnjak. Të gjithë serbët janë

të punësuar në Komunën e Leposaviqit/Leposavić. Boshnjaku dhe ashkaliu punojnë në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Dy prej serbëve të punësuar kanë shkollim të lartë, 33 kanë përgatitje të mesme profesionale, kurse dy serbë të tjerë janë punëtorë të kualifikuar. Boshnjaku e ka shkollën e mesme profesionale, ndërsa ashkaliu është punëtor i kualifikuar.

Selia e ndërmarrjes është në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Kontratat për punëtorët serb dhe boshnjakë përgatiten në gjuhën serbe. Në selinë e ndërmarrjes publike dhe në stacionet e autobusëve, të gjitha informatat, emrat e shërbimeve dhe emrat e të punësuarve janë vetëm në gjuhën shqipe. Biletat janë në gjuhën shqipe dhe serbe. Ndërmarrja nuk e ka shërbimin për përkthim, kështu që dokumentacioni publik dhe i brendshëm nuk përkthehen nga gjuha shqipe, e nuk ka as përkthim të mbledhjeve.

Ueb-faqja është në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze dhe azhurnohet rregullisht. Në ueb-faqe dhe në shtypin ditor publikohen shpalljet për punë dhe atë në të tri gjuhët. Logoja dhe emërtimi në hyrje të objektit të Hekurudhave të Kosovës në Fushë Kosovë/Kosovo Polje është gjithashtu në shqip, serbisht dhe anglisht.



Nuk kemi informata për të punësuarit para lufte sepse serbët e kanë marrë dokumentacionin me vete. E kemi kërkuar dokumentacionin por akoma nuk kemi marrë përgjigje. Neve na kanë mbetur disa dosje dhe në disa raste u kemi dalë në ndihmë ish punëtorëve që kanë kërkuar t'i marrin ato.

B.G. zyrtar i Departamentit për resurse humane në Hekurudhat e Kosovës
Intervistë e FDH 19 tetor 2007.



6. Kosovatransi

Ndërmarrja publike *Kosovatrans* është krijuar me bashkimin e *Unionit të stacioneve të autobusëve në Prishtinë/Priština* dhe *Unionit të stacioneve të autobusëve në Kosovë*. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 912, prej të cilëve 53 janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë (5,8%): në të janë të punësuar 19 romë, 11 ashkalinjë, 10 turq, 10 punëtorë nga grupi i *myslimanëve* dhe tre goranë. Në Prishtinë/Prištini janë të punësuar dy ashkalinjë dhe dy romë; në Podujevë/Podujevo tre romë; në

Mitrovicë/Mitrovica tre myslimanë dhe nga dy romë dhe ashkalinjë; në Pejë/Peć shtatë myslimanë dhe tre romë; në Gjakovë/Đakovica pesë romë dhe tre ashkalinjë; në Prizren/Prizren 10 turq, tre goranë, nga dy romë dhe ashkalinjë; në Gjilan/Gnjilane nga dy romë dhe ashkalinjë dhe në Rahovec/Orahovac janë të punësuar dy romë.

Të gjitha kontratat e punës që përgatiten për pjesëtarët e komuniteteve pakicë janë në gjuhën shqipe. Informatat në selinë e kësaj ndërmarrje publike në Prishtinë/Priština, në stacionet e autobusëve, emërtimet e shërbimeve, emrat e të punësuarve dhe biletat e autobusit, janë vetëm në gjuhë shqipe. Në *Kosovatrans* akoma nuk është formuar shërbimi për përkthim, prandaj nuk është siguruar përkthimi i dokumenteve publike dhe interne, kurse të gjitha mbledhjet mbahen në gjuhën shqipe.

Kosovatransi nuk ka ueb-faqe, kurse logoja dhe emri i kompanisë është vetëm në gjuhën shqipe. Kjo kompani nuk u ka bërë thirrje ish të punësuarve të kthehen në punë.



7. Ndërmarrja publike *Termokos* dhe Ngrohtorja e Qytetit në Gjakovë/Đakovica

Ndërmarrja publike *Termokos* siguron ngrohje për qytetarët e Prishtinës/Priština ndërsa Ngrohtorja e Qytetit për qytetarët e Gjakovës/Đakovica. Në *Termokos Prishtinë/Priština* janë të punësuar gjithsej 143 punëtorë, prej të cilëve 6 janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë: tre boshnjakë, dy goranë dhe një egjiptas. Boshnjakët dhe goranët janë të punësuar në Prishtinë/Priština. Të pestët janë me përgatitje të mesme profesionale por kanë edhe kualifikime shtesë për kryerjen e punëve në këtë ndërmarrje.²² Në *Ngrohtoren e Qytetit* në Gjakovë/Đakovica punojnë 30 punëtorë, në këtë

²² N. B. sekretar në *Termokos* në Prishtinë/Priština; Intervistë FDH, 18 tetor 2007.

ndërmarrje është i punësuar një egiptas i cili ka përgatitje të lartë profesionale dhe që ka punuar në këtë kompani edhe para lufte.²³

Të gjitha kontratat të cilat përgatiten për pjesëtarët e komuniteteve pakicë janë në gjuhën shqipe. Informatat, emërtimet e shërbimeve dhe emrat e të punësuarve janë vetëm në gjuhën shqipe. Faturat pjesërisht janë të përgatitura edhe në gjuhën serbe (pjesa e sipërme e faturës). Ndërmarrja nuk e ka shërbimin për përkthim, prandaj dokumentet janë vetëm në gjuhën shqipe, sikurse edhe mbledhjet.

Termokosi në Prishtinë/Priština dhe Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë/Đakovica nuk kanë ueb-faqen e vet. Logoja dhe emri në hyrje të kompanive është vetëm në gjuhën shqipe. Pas qershorit të vitit 1999, as *Termokosi* as *Ngrohtorja e qytetit* nuk u ka bërë thirrje ish punëtorëve të vet që të kthehen në punë.

8. Ujësjellësi dhe kanalizimi

SHUKOS është shoqatë e kompanive regjionale të ujësjellësve dhe kanalizimit në Kosovë, e cila është formuar me rregulloren e UNMIK-ut 1999/22²⁴. Atë e përbëjnë këto ndërmarrje publike: *Ujësjellësi Prishtinë/Priština*, *Ujësjellësi Mitrovicë/Mitrovica*, *Hidrodrini-Pejë/Peć*, *Hidrosistemi i Radoniqit/Radonić*, *Hidroregjioni jugor-Prizren/Prizren*, *Bifurkacioni-Ferizaj/Uroševac* dhe *Hidromorava-Gjilan/Gnjilane*. *SHUKOS-i* bën ndërlidhjen e anëtarëve të shoqatës, i promovon interesat e tyre të përbashkëta dhe i këshillona ato gjatë punës së tyre. Kompanitë në kuadër të *SHUKOS-it* nuk janë përgjegjës për furnizim me ujë dhe largimin e ujërave të zeza në enklavat serbe në veri dhe në jug të Kosovës dhe as që kanë bashkëpunim me kompanitë në enklava.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 1283: në Prishtinë/Priština punojnë 484 punëtorë, në Prizren/Prizren 170, në Pejë/Peć 174, në Mitrovicë/Mitrovica 219, në Gjakovë /Đakovica 136 dhe në Ferizaj/Uroševac janë të punësuar 100 punëtorë.

Në kompanitë regjionale të ujësjellësve dhe kanalizimeve, kontratat e punës për punëtorët nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë përgatiten në gjuhën shqipe, me përjashtim të *Ujësjellësit në Prishtinë/Priština* dhe në *Ujësjellësin Hidromorava* në Gjilan/Gnjilane, në të cilat kontratat e punës për serbët përgatiten në gjuhën serbe. Në *Ujësjellësin Prishtinë/Priština* edhe vendimet për pushimet vjetore për serbët jepen në gjuhën e tyre. Shërbimi për përkthim është krijuar vetëm në *Ujësjellësin Prishtinë/Priština*, *Ujësjellësin e Radoniqit/Radonić-Gjakovë/Đakovica* dhe *Bifurkacioni-Ferizaj/Uroševac* në të cilat punon nga një përkthyes, që bën përkthimin e dokumenteve prej gjuhën shqipe në atë angleze dhe anasjelltas. Dokumentacioni publik dhe i brendshëm i ndërmarrjeve, informatat në qendrat e ujësjellësve, emrat e të punësuarve dhe emërimet e shërbimeve janë në gjuhën shqipe. Përjashtim bëjnë faturat e *Ujësjellësit Prishtina/Priština* të cilat pjesërisht janë edhe në gjuhën serbe (pjesa e sipërme e faturës është në serbisht). Emërtimet e këtyre ndërmarrjeve publike janë në gjuhën shqipe, me përjashtim të *Ujësjellësit në Mitrovica/Mitrovica*. Në tabelën në hyrje të objektit të ujësjellësit qëndron emërtimi tre-gjuhësor i kësaj kompanie. Komunikimi mes kolegëve bëhet lirisht në të gjitha gjuhët. Zyrtarët komunikojnë me palët në atë gjuhë në të cilën pala u drejtohet.

²³ R. H, drejtor në *Termokos* në Gjakovë/Đakovica; Intervistë FDH, 8 nëntor 2007.

²⁴ http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_22.pdf


Kompanitë të cilat gjenden në veri të Kosovës, gjithsej tri, dhe një që është përgjegjëse për regionin e Shtërpçës, nuk janë në kompetencat tona sepse ata refuzojnë çfarëdo forme të bashkëpunimit me ne. Kjo paraqet pengesë të madhe në ndërtimin e strategjisë së shpenzimit të ujit në nivel të Kosovës, sepse absolutisht nuk kemi kurrfarë informatash.

N. V., drejtor i shoqatës SHUKOS
Intervistë FDH, 26 tetor 2007.

8.1. Ndërmarrjet regionale të ujësjellësve dhe kanalizimit


Ndërmarrja publike Ujësjellësi Prishtinë/Priština është përgjegjës për komunat Podujevë/Podujevo, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Glllogoc/Glllogovac, Obiliq/Obilić, Shtime/Štimlje dhe Prishtina/Priština. Selia e ndërmarrjes është në Prishtinë/Prištini. Në Ujësjellësin Prishtina/Priština janë të punësuar 484 punëtorë, 31 prej të cilëve nga radhët e komuniteteve pakicë (6,4%): janë të punësuar 26 serbë, dy boshnjakë dhe nga një punëtor nga radhët e komunitetit rom, turk dhe mysliman. Vetëm një punëtor nga grupi i myslimanëve është punësuar pas qershorit të vitit 1999, përdërisa gjithë pjesëtarët tjerë të pakicave kombëtare kanë punuar edhe para luftës.

Prej 26 serbëve të punësuar, 18 e kanë të përfunduar shkollën e mesme, dy janë me shkollë fillore, një punëtor është pa kualifikim, derisa pesë prej tyre kanë përfunduar shkollën e mesme dhe kualifikime plotësuese për punën të cilën e kryejnë. Serbët janë të punësuar në enklavat serbe të komunës: 22 punojnë në Badoc/Badovc afër Graçanicës/Gračanica, dhe nga dy në Kuzmin/Kuzmin të komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje dhe në Lipjanu/Lipljan. Të gjithë pjesëtarët tjerë të pakicave punojnë në qendrën e kompanisë në Prishtinë/Prištini. Një boshnjak e ka të kryer shkollën e mesme, tjetri ka përgatitje të lartë profesionale. Punëtorja nga radhët e grupit të „myslimanëve“ është me përgatitje të lartë profesionale. Romi dhe turku kanë përgatitje të mesme profesionale.²⁵



²⁵ M. D, drejtor i departamentit të resurseve humane në NP Ujësjellësi Prishtinë/Priština, Intervistë e FDH, 17 tetor 2007.

Ujësjiellësi regional Mitrovicë/Mitrovica është përgjegjës për territorin e komunës së Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn. Selia e kësaj kompanie është në Mitrovicë/Mitrovica. Gjithsej janë të punësuar 215 punëtorë, prej të cilëve 11 nga radhët e komuniteteve pakicë (5,1%): pesë nga grupi i *myslimanëve*, tre turq dhe tre ashkalinjë. Të gjithë pjesëtarët e pakicave punojnë në Mitrovicë/Mitrovica dhe të gjithë këta kanë punuar në ujësjiellës edhe para luftës. Njëri prej punëtorëve të grupit të *myslimanëve* e ka të kryer shkollën e mesme, tre janë punëtorë të kualifikuar, kurse një është gjysmë i kualifikuar. Të gjithë punëtorët e komunitetit turk janë punëtorë të kualifikuar, kurse të gjithë punëtorët ashkalinjë janë gjysmë të kualifikuar.²⁶





Ujësjiellësi regional *Hidroregjioni jugor-Prizren/Prizren* përgjegjës për furnizim me ujë të komunave Prizren/Prizren, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo dhe Dragash/Dragaš. Selia e kësaj kompanie është në Prizren/Prizren. Kjo kompani ka gjithsej 175 punëtorë, prej të cilëve 63 nga radhët e komuniteteve pakicë (36%): 43 punëtorë prej grupit të *myslimanëve*, 15 turq dhe pesë romë. Në ujësjiellës është i punësuar edhe një shtetas i Gjermanisë. *Myslimanët* janë të punësuar në komunat Prizren/Prizren dhe Dragash/Dragaš, kurse turqit, romët dhe një gjerman në Prizrenu/Prizren. Shumica e pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve pakicë, e kanë të kryer shkollën e mesme, kurse vetëm dy të punësuar janë me përgatitje të lartë profesionale. Gjithashtu, shumica e të punësuarve kanë punuar në ujësjiellës edhe para luftës.²⁷

Kontratat e punës dhe i gjithë dokumentacioni zyrtar është në gjuhën shqipe, por ne lëshojmë dokumentacion edhe në gjuhët tjera zyrtare nëse i punësuarit këtë e kërkon, siç ka qenë rasti me të punësuarin mysliman nga Dragashi, i cili e ka kërkuar kontratën në gjuhën boshnjake. Kemi 15 turq të punësuar dhe asnjëri prej tyre nuk e ka kërkuar kontratën e punës ose ndonjë dokument tjetër në gjuhën turke.



A.K., sekretar në NP Hidroregjioni jugor
Intervistë e FDH, 19 nëntor 2007.

²⁶ Z. M. sekretar në NP *Ujësjiellësi i Mitrovicës/Mitrovica*; Intervistë e FDH, 9 nëntor 2007.

²⁷ A.K., sekretar u NP *Hidroregjioni jugor*; Intervistë e FDH, 19 nëntor 2007.




Selia e ndërmarrjes *Hidrodrini Pejë/Peć* gjendet në Pejë/Peć dhe është përgjegjës për komunat Pejë/Peć, Klinë/Klina, Istog/Istok dhe Deçan/Dečane. Në këtë ndërmarrje janë të punësuar gjithsej 174 punëtorë, 14 prej të cilëve janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë (8%): 10 boshnjakë, tre romë dhe një serb. Të gjithë punëtorët boshnjakë dhe një serb kanë përgatitje të mesme profesionale, kurse romët kanë diplomën e shkollës fillore.



Ndërmarrja *Ujësjetlesi të Radoniqit/Radonić-Gjakovë/Đakovica* është përgjegjës për furnizim me ujë dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit të komunave Gjakovë/Đakovica, Rahovec/Orahovac dhe një pjesë të qytetit të Prizrenit/Prizren, deri te lumi Drini i Bardhë/Beli Drim. Selia e kësaj ndërmarrje është në Gjakovë/Đakovica. Gjithsej janë të punësuar 221 punëtorë, prej të cilëve 17



nga radhët e komuniteteve pakicë (7,7%): 10 egiptas, tre turq, tre boshnjakë dhe një ashkali. Nëntë nga pjesëtarët e komunitetit egiptas punojnë në Gjakovë/Đakovica, kurse një në Prizren/Prizren. Të gjithë boshnjakët dhe turqit punojnë në Prizren/Prizren. Ashkaliu është i punësuar në Gjakovë/Đakovica. Të gjithë të punësuarit nga radhët e komuniteteve pakicë kanë qenë të punësuar në ujësjellës edhe para lufte.





Selia e ndërmarrjes *Hidromorava* është në Gjilan/Gnjilane dhe ajo është përgjegjëse për furnizim me ujë dhe rrjetin e kanalizimit në komunat Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina dhe Gjilan/Gnjilane. Në këtë ndërmarrje janë të punësuar gjithsej 135 punëtorë, prej të cilëve nëntë janë nga radhët e komuniteteve pakicë (6,7%): këtu janë të punësuar shtatë serbë dhe dy turq. Një serb ka të kryer fakultetin, kurse të tjerët kanë kryer shkollën e mesme ose fillore. Punëtori nga radhët e komunitetit turk ka përgatitje të mesme profesionale dhe ai ka punuar në ujësjellës edhe para lufte, kurse tjetri është me shkollë fillore dhe është punësuar pas qershorit të vitit 1999.

Kontratat e punës dhe i gjithë dokumentacioni për punëtorët e komunitetit serb është në gjuhën serbe dhe në po këtë gjuhë komunikohet me këta punëtorë. Punëtorët e komunitetit turk nuk i kanë kërkuar kontratat e punës dhe dokumentacionin tjetër në gjuhën e tyre amtare.

N. K. Zyrtar në sektorin e resurseve humane në NP Hidromorava
 Intervistë e FDH, 1 nëntor 2007.



Ndërmarrja publike për ujësjellës dhe kanalizim *Bifurkacioni-Ferizaj/Uroševac* është përgjegjëse për territorin e komunave Ferizaj/Uroševac dhe Kaçanik/Kaçanik, kurse selia e saj është në Ferizaj/Uroševac. Në këtë ndërmarrje janë të punësuar 105 punëtor, prej të cilëve gjashtë të punësuar (5,7%) janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë dhe të gjithë janë ashkalinjë. Të gjithë ashkalinjtë punojnë në Ferizaj/Uroševac. Një nga ata ka mbaruar shkollën e mesme kurse të tjerët kanë diplomat e shkollës fillore. Tre prej tyre kanë punuar në ujësjellës edhe para lufte, kurse tre ashkalinjtë e tjerë janë punësuar pas qershorit të vitit 1999



9. Shërbimi për pastrimin e qytetit

Për pastërtinë e qyteteve, rregullimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe mirëmbajtjen e varrezave në Kosovë, kujdesen ndërmarrjet private komunale. Të gjithë pjesëtarëve të pakicave që punojnë në

këtë kompani, kontratat e punës i marrin në gjuhët e tyre amtare. Nganjëherë ndodh që vetë pjesëtarët e pakicave të kërkojnë që kontratat e punës t'u përgatiten në gjuhën shqipe, siç ishte rasti me boshnjakët në ndërmarrjen publike *Pastrimi* në Prishtinë/Priština. Komunikimi mes kolegëve zhvillohet lirisht në të gjitha gjuhët. Zyrtarët bisedojnë me palët në atë gjuhë në të cilën pala u drejtohet atyre. Gjithë dokumentacioni, informatat në qendrat e ndërmarrjeve komunale, emrat e të punësuarve dhe emërtimet e shërbimeve janë vetëm në gjuhën shqipe. Shërbimi për përkthim është krijuar vetëm në ndërmarrjen publike *Pastrimi*. Në këtë shërbim punon një përkthyes i cili përkthen dokumentet nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas.

9.1. Ndërmarrjet publike regjionale



Aktivitetet për mirëmbajtjen e qytetit për komunat Podujevë/Podujeva, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić, Ljipjan/Lipljan, Glogoc/Glogovac dhe Prishtinë/Priština i kryen ndërmarrja *Pastrimi*, selia e së cilës është në Prishtinë/Priština. Kjo ndërmarrje ka trashëguar ndërmarrjen *Komunalac*, e cila ka punuar deri në qershor të vitit 1999. *Pastrimi* është krijuar me bashkimin e tre ndërmarrjeve publike: *Hortikultura* e cila merret me rregullimin e sipërfaqeve të gjelbra *Higjiena* e cila merret me pastrimin e qytetit dhe *Tregu* e cila është marrë me pagesën e tezgave, higjienën në tregje dhe administrimin e tregjeve.

Në ndërmarrjen *Pastrimi* punojnë gjithsej 434 punëtorë, mes të cilëve janë nëntë pjesëtarë të komuniteteve pakicë (2%): katër serbë, katër romë dhe një boshnjak. Të gjithë serbët punojnë në Graçanicë/Gračanica. Dy prej tyre para lufte ishin të punësuar në ndërmarrjen *Komunalac*, në pozitën e inkasantit dhe menaxherit. Një serb është shofer, kurse tjetri punëtor fizik dhe të dy këta janë punësuar pas lufte. Një boshnjak është punësuar në qendrën e kompanisë *Pastrimi* në Prishtinë/Prištini dhe ka përgatitje të mesme profesionale. Të gjithë romët janë punëtorë fizik, dy prej tyre punojnë në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, një në komunën e Lipjanit/Lipljan dhe një në komunën e Podujevës/Podujevo. Boshnjaku dhe romët janë punësuar në këtë kompani pas lufte.



Pas vendosjes së administratës së UNMIK-ut, në qershor të vitit 1999, *Pastrimi* u ka bërë thirrje publike serbëve që të kthehen në vendet e tyre të punës, për herë të parë në korrik me anë të një lajmërimi në gazetën ditore *Koha Ditore*, kurse herën e dytë në shtator të 1999-ës, e cila është publikuar në tabelën e shpalljeve të *Pastrimit*. Të dy shpalljet ishin në gjuhën shqipe.

Pas lufte, me datë 23 korrik 1999, përmes gazetës „Koha Ditore” ne u kemi bërë thirrje të gjithë punëtorëve të kthehen në vendet e tyre të punës në ndërmarrje. Me datë 24 shtator të vitit 1999, kemi publikuar një lajmërim në gjuhën shqipe, në tabelën e shpalljeve në hapësirat e ndërmarrjes tonë, duke u bërë thirrje të gjithë punëtorëve që kanë punuar para lufte të kthehen në punë. Dy apo tre punëtorë të komunitetit serb na kanë kontaktuar përmes telefonit dhe i kemi njoftuar se mund të kthehen në punë. Janë kthyer vetëm dy, të cilët edhe sot e kësaj dite punojnë në Graçanicë.

H. M. sekretar në NP *Pastrimi*
Intervistë e FDH, 17. tetor 2007.





Ndërmarrja publike *Uniteti*, aktivitetin e vet e ushtron në komunat Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn. Selia e kompanisë është në Mitrovicë/Mitrovica. Në këtë ndërmarrje janë të punësuar 177 punëtorë, dy prej të cilëve janë nga radhët e komuniteteve pakicë (1,1% prej numrit të përgjithshëm të punësuarve): janë të punësuar një boshnjak dhe një ashkali, të dy kanë punuar në këtë kompani edhe para lufte, kanë përgatitje të mesme profesionale dhe punojnë në Mitrovicë/Mitrovica.





Për pastrimin e komunave Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica dhe Viti/Vitina përgjegjëse është ndërmarrja publike *Higjiena* selia e së cilës gjendet në Gjilan/Gnjilane. Në *Higjienë* janë të punësuar 140 punëtorë, 16 punëtorë nga radhët e komuniteteve pakicë (11.4% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve): 14 serbë, një rom dhe një turk. Gjashtë serbë janë të punësuar në Gjilan/Gnjilane, kurse nga katër në Viti/Vitina dhe Kamenicë/Kamenica. Pjesëtari i komunitetit rom



dhe ai turk janë të punësuar në Gjilan/Gnjilane. Të gjithë punëtorët nga radhët e komuniteteve pakicë janë kryesisht me përgatitje të mesme profesionale, kurse një numër i vogël kanë të kryer shkollën fillore.





Ndërmarrja publike *Higijena publike* mirëmban qytetet Pejë/Peç, Deçan/Deçane, Klinë/Klina dhe Istog/Istok. Selia e kompanisë është në Pejë/Peçi. Gjithsej janë të punësuar 130 punëtorë, prej të cilëve 23 janë pjesëtarë të pakicave (17% prej numrit të përgjithshëm të të punësuarve): tetë boshnjakë, nëntë rom dhe gjashtë serbë. Të gjithë boshnjakët punojnë në Pejë/Peçi, romët në komunat Pejë/Peç dhe Istog/Istok, ndërsa serbët në Klinë/Klina dhe Istog/Istok. Të gjithë punëtorët nga radhët e pakicave kryesisht kanë të kryer shkollën e mesme kurse një numër i tyre ka shkollim fillor.



Eko regjioni është ndërmarrje publike e cila aktivitetin e vet e kryen në territorin e komunës Prizren/Prizren, Malishevë/Mališevo, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac dhe Suha Rekë/Suva Reka. Selia e kompanisë është në Prizren/Prizren. Në këtë ndërmarrje punojnë gjithsej 242 punëtorë, prej të cilëve 71 punëtorë janë nga radhët e komuniteteve pakicë (29%): 40 janë boshnjakë, 29 rom dhe dy pjesëtarë të komunitetit turk. Pesë boshnjakë punojnë në komunën e Dragashit/Dragaš, kurse 35 në komunën e Prizrenit/Prizren. Tre romë punojnë në Rahovec/Orahovcu, katër në Suharekë/Suvoj Reci dhe 22 në Prizren/Prizren. Dy pjesëtarë të komunitetit turk punojnë në Prizren/Prizren. Të gjithë të punësuarit nga radhët e pakicave kombëtare kanë qenë të punësuar edhe para lufte dhe shumica kanë të kryer shkollën fillore.



Ndërmarrja publike *Çabrati* është përgjegjës për mirëmbajtjen e qytetit të Gjakovës/Đakovica. Gjithsej janë të punësuar 109 punëtorë, prej të cilëve 61 janë nga radhët e komuniteteve pakicë (56%): 51 egjiptas, pesë romë dhe pesë ashkalinjë. Të gjithë pjesëtarët e punësuar nga radhët e pakicave kanë punuar në këtë ndërmarrje edhe para lufte dhe pjesa më e madhe e tyre e ka të kryer shkollën fillore. Një pjesë më e vogël e të punësuarve kanë përgatitje të mesme profesionale



Rekomandimet

në lidhje me ligjin kundër diskriminimit

- Qeveria e Kosovës duhet të përcaktojë përqindjen e pakicave që duhet të punësohen në ndërmarrjet publike, në përputhje me përfaqësimin e pakicave në popullsinë e përgjithshme, e që gjatë kësaj të mos rrezikohet funksionimi profesional i ndërmarrjeve publike, në të mirë të gjithë qytetarëve të Kosovës.
- Përqindja e të punësuarve pjestarë të komuniteteve pakicë në ndërmarrjet publike duhet të pasqyrojë strukturën etnike regjionale në të cilin funksionon ajo ndërmarrje. Në rastet e ndërmarrjeve siq është Aeroporti Prishtinë/Priştina, përqindja e të punësuarve që janë pjestarë të komuniteteve pakicë duhet të pasqyrojë strukturën etnike të Kosovës.
- Gjatë përcaktimit të përqindjes për punësimin e pakicave në ndërmarrjet publike, Qeveria e Kosovës duhet të marrë parasysh strukturën nacionale të popullsisë në regjionin e caktuar, përgatitjen profesionale dhe nevojat e posaçme të popullsisë.
- Pjesëtarët e komuniteteve pakicë duhet të përfaqësohen edhe në vendet udhëheqëse, në përputhje me përgatitjen profesionale, njohuritë dhe nevojat për funksionim profesional të ndërmarrjeve publike, në të mirë të gjithë qytetarëve të Kosovës.
- Ndërmarrjet publike duhet ta definojnë strategjinë e punësimit, ashtu që ajo të ketë parasysh punësimin e pjesëtarëve të pakicave dhe për ngritjen e tyre profesionale, në mënyrë që të arrihet integrimi i tyre në shoqërinë kosovare.

në lidhje me ligjin për përdorimin e gjuhëve

- Të gjitha ndërmarrjet publike në Kosovë duhet t'i respektojnë në tërësi dispozitat e ligjit mbi përdorimin e gjuhëve.
- Ndërmarrjet publike duhet t'i përkthejnë rregulloret e punës, kontratat e punës dhe gjithë dokumentacionin tjetër të brendshëm, në gjuhët zyrtare të Kosovës.
- Në komunat në të cilat përpos gjuhëve zyrtare në Kosovë statusin e gjuhës zyrtare e kanë edhe gjuhët tjera, rregulloret e punës, kontratat e punës dhe dokumentacioni tjetër publik dhe i brendshëm duhet të përkthehet në gjuhët zyrtare të atyre komunave.
- Në komunat ku gjuha boshnjake dhe/ose turke janë gjuhë zyrtare, të gjitha institucionet e qeverisë së Kosovës dhe ndërmarrjet publike duhet të respektojnë në tërësi dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe të gjithë të punësuarit boshnjak dhe turk në këto ndërmarrje duhet të marrin dokumentacionin në gjuhët e tyre amtare.

- Në komunat ku gjuha boshnjake dhe/ose turke janë gjuhë zyrtare, duhet të sigurohen të gjitha kushtet që qytetarët dhe të punësuarit në ndërmarrjet publike nga radhët e këtyre komuniteteve ta marrin dokumentacionin në gjuhët e tyre.
- Kontratat e punës duhet të jenë në gjuhët amtare të punëtorëve.
- Ndërmarrjet publike duhet t'i japin faturat në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë.
- Në të gjitha ndërmarrjet publike duhet të krijohen shërbimet për përkthim ashtu që gjithë dokumentacioni të përkthehet në gjuhët zyrtare të Kosovës, si dhe në gjuhët zyrtare të komunave.
- Ndërmarrjet publike duhet të sigurojnë buxhet për punësimin e numrit të mjaftueshëm të përkthyesve, në mënyrë që qytetarët dhe gjithë të punësuarit të informohen si duhet dhe ta marrin në kohë dokumentacionin e nevojshëm në gjuhët e tyre.
- Gjatë përgatitjes së dokumenteve të cilat u jepen qytetarëve, me kërkesë të tyre, zyrtarët e ndërmarrjeve publike duhet t'i respektojnë rregullat drejtshkrimore dhe ato gramatikore të gjuhës në të cilën lëshohet dokumenti.